



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR RREGULLAT E PËRDORIMIT TË RRJETEVE SOCIALE DHE MEDIAS**  
**ONLINE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE NË ZGJEDHJE**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2 të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë tjetër që ky ligj nuk ia njuh shprehimisht Rregullatorit os KAS-it.

Në zbatim të nenit 19, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor, Komisioneri kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara është hartuar projektvendimi “Për rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje”, i cili synon përmirësimin dhe adresimin e të gjitha shqetësimeve apo problematikave të hasura deri më sot nga përdorimi i rrjeteve sociale dhe medias online, nga institucionet publike në zgjedhje.

Ky projektvendim ka si qëllim parandalimin e sjelljes apo përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, si dhe gjatë fushatës zgjedhore me qëllim nxitjen e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike, për krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e tyre për qëllime partiake.

Projektvendimi ka për synim të krijojë një kornizë ligjore dhe rregullatore që do të përcaktojë qartë rregullat dhe standardet për përdorimin e rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike gjatë periudhave zgjedhore. Kjo do të sigurojë që këto platforma të përdoren në mënyrë të përgjegjshme dhe të drejtë, duke shmangur manipulimin e informacionit dhe përdorimin e tij për përfitime politike. Përmes kësaj kornize, do të vendosen rregulla për të mbrojtur transparencën, paanshmërinë dhe për të garantuar që proceset zgjedhore të jenë të lira dhe të barabarta, për të siguruar një proces zgjedhor të ndershëm.

Funksionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt apo indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjete sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale duhet të lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.

Gjithashtu, ndalohet pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik.

Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje”.

**Pavlina DOÇAJ – Drejtorja e Ligjshmërisë**

**Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Tiranë më

Nr.

Prot.

Data: xxxxxxxxx

Nr:

Ora:

**VENDIM**

**PËR**

**RREGULLAT E PËRDORIMIT TË RRJETEVE SOCIALE DHE MEDIAS ONLINE**  
**NGA INSTITUCIONET PUBLIKE NË ZGJEDHJE**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh” e “n”, dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S:**

1. Funkionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt apo indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjete sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe elektorale lejohet vetëm në llogaritë personale në këto rrjete.
2. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive të ndaluara në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të funksionarit publik.
3. Ndalohet pasqyrimi i veprimtarive politike dhe elektorale, postimi i mesazheve elektorale në faqet zyrtare të internetit, në rrjetet sociale të institucionit publik, si dhe në ato zyrtare të vetë funksionarit publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**

Data: Nr:

Ora:



“Për rregullat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online nga institucionet publike në zgjedhje”